

Nr. i pozitës. 306

Titulli i pozitës:	Shtëpiak		
Fakulteti/ Departamenti:	Departamenti i ngrehinave		
Qendra/Sektori:			
I raporton:	Drejtorit të ngrehinave		
Mbikëqyr:			
Statusi dhe Rangu:	Orar të plotë: ✓ Orar të pjesshëm:	Rangu i pozitës:	

Qëllimi primar i pozitës
Të realizojë mirëmbajtjen rutinore dhe preventive si dhe riparimin e pajisjeve dhe sistemeve të UEJL , me një theks të veçantë të punëve elektrike dhe mekanike

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore
Të kryej riparime të vogla dhe të mëdha të ndërtesave, pajisjeve ose sistemeve sipas shkathtësive dhe përvojës specifike si që janë punë elektrike ose mekanike
Të kryej riparime tjera të përgjithshme dhe detyra tjera të mirëmbajtjes brenda fushës së kompetencës ashtu siç kërkohet
Të kryejë mirëmbajtjen e ndërtesave, pajisjeve ose sistemet e shërbimeve në bazë të planeve të caktuara
Të riparoj ose zëvendësoj pajisjet e tilla si dritare ose dyert
Të ndihmoj në renovimin dhe dekorimin e objekteve brenda dhe jashtë
Të ruaj punën e përditshme të sistemit të ngrohjes dhe ftohjes
Të bëj instalimin e sistemeve të reja, si elektrike dhe kablove TI si dhe pajisjeve, siç kërkohet brenda fushës së kompetencave
T'ju përgjigjet në mënyrë efikase kërkesave emergjente të mirëmbajtjes ashtu siç kërkohet
Të bëj vlerësimin për furnizime dhe pjesë për riparimin dhe ti porosit ato në mënyrën e autorizuar
Të realizojë kontrollin ditor, javor dhe mujor në ndërtesat e identifikuara, pajisjet ose sistemeve ashtu siç është specifikuar në procedurë
Të raportoj problemet, shkelje të rregullave ose rrethana të jashtëzakonshme të cilat mund të jenë të dëmshme për stafin, studentët ose vizitorët në mënyrë efikase tek mbikëqyrësi
Të vlerësojnë punën e vetë dhe të kompletojnë raportet ashtu siç kërkohet
Të merr pjesë në procesin e vetë-vlerësimit të Universitetit dhe të merr pjesë në trajnime relevante, duke përfshirë ndarjen e praktikës dhe përvojës së mirë
Të përmbush detyrat dhe përgjegjësitë në mënyrë ligjore dhe të sigurt
Të përmbush detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me Statusin, politikat, procedurat dhe udhëzimet, si dhe me misionin Universitetit për përsosmëri dhe barazi
Të kryej detyra tjera në pajtim me rangun e postit ashtu siç edhe do të kërkohet në mënyrë të arsyeshme

Universiteti i Evropës Juglindore

Kualifikimet, njohuritë dhe përvoja

Themelore:

- Shkollë të mesme tre vjeçare elektrike ose mekanike
- Pesë vjet pune në lëmi të ngjashme
- Njohje në përdorimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve dhe sistemeve

Preferohet:

- Njohje dhe përvojë në lëmi të ngjashme si hidraulik, bojaxhi
- Kualifikim për ndihmën e parë

Shkathtësitë dhe aftësitë


Thelbësore:

- Komunikim efektivë (gojor dhe të shkruar) së paku në njërën nga tre gjuhët zyrtare që përdoren në nivel të Universitetit (shqip, maqedonisht, anglisht))
- Shkathtësi efektive ndër-personale
- Aftësi për të punuar në mënyrë fleksibile me mbikëqyrje minimale
- Aftësi për të punuar me vetë iniciativë dhe zgjidh problemet rutinore
- Aftësi për të punuar në ekip
- Prezencë dhe përpikëri të shkëlqyeshme dhe përdorim efektive të orarit të punës
- Shkathtësi të mira organizative
- Aftësi për të përdorur aplikacione relevante kompjuterike për ti përmbush kërkesat e punës
- Aftësi të mira fizike të mira të qëndrojnë, përkulet, ngrejë, shty dhe tërheq objekte dhe të kryej lëvizje të përsëritura ashtu siç kërkohet nga pozita
- Aftësi për të përdorur pajisje ashtu siç kërkohet për pozitën, përfshirë pajisje elektrike
- Aftësi për të punuar mirë nën presion dhe të përmbush detyrat brenda afatit
- Aftësi për të punuar në mënyrë pozitive dhe përkrahëse me stafin dhe studentët
- Dëshirë për të ndjekur trajnime

Preferohet:

Diagrami organizativ

Departamenti i Ngrehinave



Elektriku	Të bëj instalimet themelore elektrike, punë riparuese me kablo, prizmat ndërprerësit dhe qarqet elektrike; Të riparoj sistemet e dritave dhe kontrollojë sistemet elektrike për kushte të sigurisë
Hidrauliku	Të identifikoj dhe realizoj riparimet hidraulike; linja të hapura të bllokuara dhe kanalizimet, të zëvendësoj lavamanët dhe pjesët tjera të vogla; të mirëmbajë dhe vëzhgojë sistemet
Bojaxhiu	Të përgatit sipërfaqe për ngjyrosje, emalim, lyrje me llak ose lustrim; të bëj suvatimin dhe të ngjitjen e tapeteve ashtu siç kërkohet dhe riparojë mbulesat e murit

Pranimi dhe rishikimi	
Nënshkrimi i mbajtësit të postit:	Data:
Nënshkrimi i drejtorit:	Data:
Rishikimi	
Nënshkrimi i mbajtësit të postit:	Data:
Nënshkrimi i drejtorit:	Data: